



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**Procesverbal 02/2025**

I Mbajtur në takimin e II-të të rregullt të KK-së me datën 28.02.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

**Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;**

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

**Rendi i ditës:**

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim - Vendim për Miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025;
5. Propozim - Vendim për caktimin e dy anëtarëve nga Kuvendi i Komunës për Komision për ndarjen e bursave për studentë për Vitin shkollor 2024/2025;
6. Pyetje dhe kërkesa dhe
7. Të ndryshme.

## **Pika shtesë**

- 1. Propozim – Vendim për anulimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 4978 datës 16.11.2007  
dhe dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.**
- 2. Propozim – Vendim për ndryshimin e vendimit 01.Nr. 20 për plotësimin e listës rezervë me emërtimet e rrugëve dhe shesheve publike në Komunën e Ferizajt.**

Kryesuesi pasi e lexi rendin e ditës se lartëcekur pyeti nëse ka dikush rrëth rendit të ditës dhe pasi spati e hodhi në votim rendin e ditës i cili u miratua me 33 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim, më pas kryesuesi vazhdoi me procesverbalin dhe pasi spati vërejtje u miratua me 33 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e lexi pikën e 4-të të rendit të ditës e cila ishte miratimi i Planit Vjetorë të Kuvendit edhe këtu s'pati të interesuar për diskutim dhe u miratua me 33 vota për, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryesuesi e lexi pikën e 5-të lidhur me bursat dhe duhen dy propozime nga kuvendi për antarë të komisionit.

Arian Imeri nga PDK-ja propozoi Elbasan Osmani, ndërsa Brahim Osmani nga LVV-ja propozojnë Nazer Beqirin dhe këta dy u hodhën për votim dhe kaloi me 33 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexi pikën e 6-të lidhur me Komisionin për Ndarje të Banesave, dhe fjalën ia kaloi Mimoza Pajazitit, e cila pasi përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se edhe në KPF kam propozu që të formohet ky komision dhe në kuader të Ligjit për vetëqeverisjen lokale duhet

të ketë 5 anëtarë ku nga egzekutivi kemi këto propozime: Sabri Murseli, Kemajl Emini dhe Luan Jahiri nga kategoritë e dalura nga lufta, ndërsa nga legjislativi në kuadër të PDK propozojmë Hyzri Kamenica, ndërsa nga LVV-ja, Brahim Osmani e propozojë Adnan Selmanin për këtë komision.

Kryesuesi i lexoi edhe njëherë këta emra dhe i hodhi për votim dhe kjo pikë kaloi me 33 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën në lidhje me plotësim ndryshimin e Listës rezerve dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Arbër Bytyqi, ky propozim ka të bëjë lidhur me plotësim ndryshimin e listës rezervë dhe ministria ka kërkuar që të bëhen disa përmirësime ashtu si janë të parapara në këtë propozim.

Faik Selmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sa i përket këtij propozimi p.sh. Imri Halili veç është në një listë kryesore dhe s'mund të pranohet në sistem, se unë e di se punojë me këto punë edhe Ahmet Hoxha veç se ekziston, meqenëse u kthy kjo, propozojë një emër Jakup Sadiku.

Elbasan Osmani meqenëse u shfrytëzu rasti për propozime të reja, unë i kam disa propozime familjare Adnan Muhadini, Hasan Reqica, Rexhep Muhadini, "Udha e Malit" këto janë propozime familjare dhe mund t'i përcjelli edhe direkt për procesverbal, megjithëse këto janë ardhë jashtë afatit.

Xhavit Zariqi theksoi se meqenëse këto propozime janë ardhë jashtë afatit, pasi më dy emra të njejt ska mundësi, e qes në votim dhe kjo pikë kaloi me 33 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim.

### **Pyetje dhe kërkesa;**

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se meqenëse një pjesë e drejtorëve s'janë këtu, disa kërkesa që i kanë adresu qytetarët kam edhe pyetje p.sh.:

Rugja "Besnik Osmani" në qytet është në gjendje shumë të rëndë dhe duhet të intervenohet menjëherë, po ashtu prapë është kërkesë e Fshatrave si Rahovicë, Pojatë, që të shtrohen rrugicat atje, megjithëse këto hynë në buxhet si çdo vit dhe asnjëherë nuk shtrohen, ndërsa një pyetje që ja kisha ba Drejtorit të shëndetësis, laboratori i analizave në Fshatin Softaj është marr dhe nuk dihet pse është marr, pa pas ndonjë arsyе pse është marr.

### **Të ndryshme:**

Në të ndryshme fjalën e morri Amir Rexhepi i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë dua të ngris një shqetësim të prindërve që kanë fëmijët me sindrom down, e që ky kuvend kishte ndar një parcelë që do të shfrytëzohej nga personat me nevoja të veçanta, vitin e kalum është mbajt një konferencë e donatorëve ku kanë marrë pjesë përfaqësues të bizneseve dhe propozimi për ndërtimin e objektit ka marr kahje ndërsa në këtë objekt janë shfaqur disa probleme ku ka qenë të involvuar edhe komuna, respektivisht nënkyetari i Komunës Lulzim Aliu, pasi edhe Drejtori është këtu i kadastrit është mirë me na jep skjarime sa i përket këtij objekti, kur është nda parcela është nda që të shfrytëzohet nga personat me nevoja të veçanta dhe kanë apliku hendikosi dhe down syndrom ku "Handikos" kërkon që të aplikojë me një shumë mbi 200 mij euro në mënyrë që ta lejon ta shfrytëzojnë katin e dytë dhe kujt duhet t'i kthehen këto mjete, pasi doën syndromi është zotu që duhet ta rregullojë pjesën e brenshme dhe kërkojë që në seancën e radhës të vij nënkyetari këtu dhe të jap

skjarime, po masi është këtu edhe drejtori është mirë të jap skjarime pasi kjo organizatë funksionon me të hyra vetanake dhe është mirë dhe kemi obligim që t'i dalim në ndihmë këtyre kategorive.

Sabri Murseli, fillimisht kjo parcele është e ndar, fillimisht për doën syndrom ndërsa financimi është ba nga donatorët e jashtëm dhe me sa e di ka ndodhur një marrveshje në mes tyre d.m.th. organizatave dhe ky problem ka lindur në mes tyre dhe komuna i ka përfunduar procedurat e tija sa i përket ndarjes së parceles dhe ofrimit të kushteve për rregullimin e tyre d.m.th infrastrukturën, ndërsa mënyrën e financimit të objektit dhe ndarja e hapsirave është çështje që ka të bëjë në mes të dy organizatave dhe komuna ska asnje të drejtë që të përzihet se si të ndahan hapsirat dhe si të shfrytëzohen ato.

Xhavit Zariqi theksoi se ne si kuvend ia kemi nda parcellen dhe kemi bërë më të mirën në afate të caktuara për zhvillimin e këtij projekti, ndërsa në mosmarrveshje në mes organizatës ne s'kemi drejt madje as të përzihemi, urdho edhe njëherë Amir.

Amir Rexhepi unë thash që nënkyetari prej fillimit ka qenë i involvum në këtë çështje, kur u nis objekti shumë janë kanë gëzu fëmijët dhe tash i takova prindërit e fëmijve, thanë na kanë qit prej objektit dhe po thojnë për me shfrytëzu duhet me i dhanë kaq pare, madje as oborrin as liftin, madje kujt me ju kthy kjo shumë, pasi donatorët s'kanë interes mi kthy mjetet, madje kam informacione se disa donator kur i kanë pa këto probleme janë tërhjek nga premtimet.

Xhavit Zariqi theksoi në rregullë Amir, shko te nënkyetari dhe pyete privatisht, pasi kjo çështje ska të bëjë fare me kuvendin, nëse ska të tjerë për të diskutuar unë e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtësi

Leutrim Mahmuti



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi